

STATUTI DHE AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"G88 Construction" Sh.p.k

Sot, me daten: 10.02.2025, me deshiren dhe vullnetin e tij te lire dhe te pavesuar **Z. Danjel Garunja**, i biri i Sherifit dhe Belkizes, lindur me 15.05.1988 ne Tirane dhe banues ne Tirane, Rruga "Hamdi Garunja", madhor, me zotesi te plote per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, i identifikuar me ane te leternjoftimit me nr 037629966 dhe nr:I80515074D personal, ne cilesine e ortakut themelues krijon:

Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "G88 Construction" Sh.p.k. Statuti dhe Akti i themelimit eshte akti baze ku do te mbeshtetet themelimi i shoqerise tregtare "G88 Construction" sh.p.k si dhe zhvillimi i metejshe i saj.

NENI 1

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

1.1 Ortaku i Vetem i kesaj shoqerie eshte Z.Danjel Garunja dhe zoteron 100 % te kapitalit te shoqerise.

NENI 2

EMERTIMI I SHOQERISE

2.1. Shoqeria mban emrin "G88 Construction" Sh.p.k dhe eshte person juridik shqiptar. Shoqeria do te kete simbolet dhe vulen e saj personale.

2.2. Shoqeria "G88 Construction" sh.p.k, (ne vijim "Shoqeria") krijohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar me nje ortak te vetem Z.Danjel Garunja, dhe veprimtaria e saj rregullohet me ane te ketij statuti dhe akt themelimi.

2.3. Statuti eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, rregullohen nga ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

3.1. Shoqeria e ka qendren ne Tirane, ne adresen: Rr Ibrahim Rugova, Sky Tower Nr.5 Sky Tower, Ap.12/4, Tirane me numer pasurie 3/219 + 1 - 36, Zona Kadastrale 8270.

, Tirane dhe gezon te drejten per te hapur filiale ose dege te tjera ne Shqiperi dhe jashte saj.

3.2. Njesite strukture, deget dhe perfagesite do te ndertohen konform legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe me ate te vendeve te tjera ku ajo mund te hape dege.



NENI 4

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

4.1. Shoqeria "G88 Construction" sh.p.k do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj prane Q.K.B.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

5.1. Shoqeria eshte themeluar per te vepruar ne fushen e :

- Ndertimit te objekteve civile dhe industriale; zbatimit te projektimit dhe planvendosjes se objekteve te vecanta; projekte dhe ndertime civile, dhe zbatim projektesh ne fushen industriale, minerare, hidroenergjitike, energjie diellore, (panelet diellore), energjie me ere; hoteleri; turizem; shitje dhe blerje me shumice dhe pakice brenda dhe jashte vendit te artikujve te ndryshem industriale, bujqesore dhe blegtorale; transportit dhe speditimit te mallrave dhe artikujve te lejuar ne qarkullimin civil si dhe te udhetareve; konsulences ne fushen e ekonomise dhe kontabilitetit financiar; shitjes dhe blerjes se pasurive te paluajtshme dhe te luajtshme; kultivimit te farnave dhe variteteve te ndryshme bujqesore; mbareshtimit te racave te ndryshme te bagetive blegtorale si dhe te kafsheve per qellime sportive; etj.

5.2. Gjithashtu, shoqeria do te mund te kryeje cdo aktivitet tjeter ekonomik, tregtar, financiar qe gjykohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e objektit te shoqerise, perfshire shitjen e mjeteve te shoqerise si makinerite, pajisjet, marrja dhe dhenia me qira, te qenit garant, hipotekimi dhe pjesemarrja ne shoqeri te tjera.

5.3. Shoqeria mund te kryeje cdo operacion tregtar, operacione qe lidhen me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, operacione financiare dhe kredimarrje, t'u jape garanci te treteve si dhe te bleje dhe shese ose marre me qira ndermarrje, dege ndermarrjesh, si dhe te kete pjesemarrje ne shoqeri te tjera, ente ose konsorciume, te themeluara apo ne themelim e siper, qe kane objekt te njejte ose te ngjashem me te vetin apo gjithsesi funksional per arritjen e qellimeve te shoqerise. Me ne pergjithesi shoqeria do te mund te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te shoqerise.

5.4. Aktivitetet e siperpermendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, te miratuar nga Ortaku i vetem.

NENI 6

PERGJEGJESIA E ORTAKEVE

6.1. Pjesemarrja ne shoqeri nuk pengon pavaresine ligjore, organizative dhe te pronesise se ortakëve.

6.2. Ortaku qe merr pjese ne kete shoqeri, nuk eshte pergjegjes per detyrimet qe lindin gjate aktivitetit tregtar te shoqerise, tej kapitalit themeltar te saj qe vete ai ka nenshkruar, gjithashtu shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet personale te ortakut te saj.



KREU II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

NENI 7

KAPITALI I SHOQERISE

7.1. Kapitali i shoqerise "G88 Construction" Sh.p.k perbehet nga para me nje vlere te barabarte me 100 000 (njqind mije) leke. Ky kapital ndahet ne 1 (nje) kuote te barabarte me vlere 100 000 (njqind mije) leke, e cila zoterohet 100 % nga Ortaku i Vetem, Z. Danjel Garunja.

7.2. Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne çdo moment, nje ose disa here, me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

7.3. Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Ne çdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufirin qe percakton ligji. Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

NENI 8

TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

8.1. Kapitali themeltar ose pjese te veçanta te tij, jane te transferueshme nga ortaku i vetem tek te tretet. Transferimi i kapitalit apo pjeseve te tij nga ortaku ne favor te te treteve, kryhet gjithnje pas miratimit te tij me vendim dhe me akt noterial te posaçem.

8.2. Nese nje nga ortaket, qe mund te shtohen me vone ne shoqeri deshiron te shese kuotat e tij ai duhet te respektoje te drejten e parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te kesaj shoqerie.

8.3. Te gjitha veprimet e shoqerise qe kane te bejne me zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar, qe te konsiderohen te vlefshme duhet te miratohen nga Ortaku i Vetem.

8.4. Ne çdo rast vleresimi i kapitalit ne natyre qe zoteron apo do te krijoje shoqeria ne te ardhmen do te behet me vendim nga Ortaku i Vetem ose nga nje ekspert kontabel i emeruar nga ortaku i Vetem.

NENI 9

TRANSFERIMI I KUOTAVE

9.1. Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;



- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

9.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

9.3. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT" i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

KREU III

NENI 10

ORGANI VENDIMARRËS

10.1. Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

10.2. Ortaku i Vetëm, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shperblimeve;
- d) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asambleve;
- g) ndryshimin e statutit, e selisë së shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve të saj.
- h) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të shoqërisë;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.

10.3. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i vetëm duhet të regjistrohen në librin e procesverbaleve sipas nenit 90 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

NENI 11

ADMINISTRATORI

11.1. Administrator i shoqërisë emërohet Z. Danjel Garunja, i biri i Sherifti dhe Belkizes, lindur më 15.05.1988 në Tiranë, Rr "Hamdi Garunja" i identifikuar me anë të letërnjoftimit me nr 037629966 dhe nr: I80515074D.

11.2. Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërteritje bazuar në nenin 95/1 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

11.3. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.



11.4. Administratori me pelqimin e ortakut per procese te ndryshme aktivitetit te shoqerise qe kerkojne njohuri te posacme ne nje fushe te caktuar, mund te punesoje me kontrate cdo person qe i zoteron keto njohuri dhe ne kontraten specifike te sherbimit ai mund ti jape te drejten e marrjes se vendimeve specifike operative ne lidhje me permbushjen e detyrimeve kontraktore ne zbatimin e projekteve ose kontratave specifike qe lidhen me ato kushte specifike profesionale dhe me pamundesine fizike te qenies i pranishem ne momentin e kryerjes se punimeve te tilla per llogari te kontratave me te tretet.

NENI 12

KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

12.1. Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatisi dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve dhe t'i paraqesi per miraçim tek ortakut i vetem i shoqerise;
- d) krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) te kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
- e) te raportoje perpara ortakut te vetem ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

12.2. Administratori eshte i detyruar t'i beje thirrje ortakut te vetem qe te marre vendim, ne rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.


12.3. Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve.

12.4. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqerise.

12.5. Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e tij.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Pergjegjessite



Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

NENI 13

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

13.1. Kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për tre vite financiare, me mundësi rizgjedhjeje. Shkarkimi i ekspertit kontabel të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, në rast se kryhen shkelje, vërehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

NENI 14

VITI FINANCIAR



14.1. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga Administratori dhe nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga ortakut i vetem.

NENI 15

BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET

15.1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

NENI 16

MBARIMI I SHOQERISE

16.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Ortakut te Vetem;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT" ndryshuar;
- d) me vendim te gjykates;

16.2. Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej saj emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " *Shoqeri ne likuidim e siper* ".

16.3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

16.4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit, te emeruar nga Ortaku i Vetem. Nese Ortaku nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

NENI 17

TRANSFORMIMI I SHOQERISE

17.1. Transformimi i shoqerise behet me vendim te Ortakut te Vetem ose kur ekzistojne faktore te jashtem detyrues ligjore, ne keto raste vendimi merret pasi i eshte paraqitur ortakut nje raport mbi gjendjen e shoqerise nga ana e administratorit.

17.2. Cdo transformim i bere ne kundërshtim me kete nen eshte i pavlefshem.

NENI 18

BAZA LIGJORE



18.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

18.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e Kodit Civil, te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

NENI 19

MOSMARREVESHJET

19.1. Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te tentohet te zgjidhen me konsensus dhe mirekuptim.


19.2. Ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve do te jete Gjykata e shkalles se pare te Juridiksionit te pergjithshem Tirane.

NENI 20

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Ky Statut u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte juridike.

ORTAKU I VETEM

Handwritten signature in blue ink, appearing to read "Daniel Gargaj". Below the signature is a large, stylized blue ink flourish or mark.